



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE	
№. Prot. Br. Prot. Prot. No.	01 779
№. Fjalor Br. Shtetes No. Pages	01 31.07.2026
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues / Upravni Odbor/ Steering Committee

Nr. 01/ 779/2026
Datë: 30/07/2026

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe nenin 6, paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/L0197 për Zyrarët Publik më datë 30 Korrik 2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja Nr.17/2026 për Kompensimin për Funkcion Shtesë dhe Ekspertë.
- II. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit Ekzekutiv të AD-së;
- Drejtoreshës së DSHLP-së;
- Burimeve Njerëzore të AD-së;
- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë.

Fejzullah Rexhepi
Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, si dhe nenit 6, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 korrik 2026, miraton:

RREGULLORE Nr. 17/2026
PËR KOMPENSIMIN PËR FUNKSIONIN SHITESË DHE PËR EKSPERTËT

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë kriteret dhe procedurat për kompensimin për funksion shtesë të zyrtarëve të Akademisë, si dhe kategorizimin e Sistemit SMAT dhe pozitat e ekspertëve që punojnë me të.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për zyrtarët e Akademisë së Drejtësisë, të cilët emërohen ose caktohen për të shërbyer në një bord, komision profesional apo organ tjetër përkatës që përbën funksion shtesë, si dhe për pozitat e Akademisë që kategorizohen si ekspertë.

Neni 3
Përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **Zyrtari i Akademisë**- nënkupton anëtarët e Këshillit Drejtues, anëtarët e Këshillit Programor dhe nëpunësit civilë me status të veçantë të Akademisë së Drejtësisë;

1.2. **SMAT** – nënkupton Sistemi Informativ për Menaxhimin e Aktiviteteve Trajnuese në Akademi;

1.3 **Akademia** - nënkupton Akademinë e Drejtësisë;

1.4 **Këshilli Drejtues** - nënkupton organin drejtues të Akademisë;

1.5. **Këshilli Programor** - nënkupton organin profesional të Akademisë;

1.6. **Komision/Bord** – nënkupton Këshillin Drejtues, Këshillin Programor, Komision, panel apo organe të ngjashme.

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë, siç janë përdorur në ligjin përkatës për pagat në sektorin publik, ligjin përkatës për zyrtarët publik, ligjin përkatës për menaxhimin e financave publike si dhe legjislacionin relevant në fuqi.

KAPITULLI II

KOMPENSIMI, KRITERET DHE VLERA PËR KOMPENSIM

Neni 4

Kompensimi për funksionin shtesë

1. Zyrtari i Akademisë, i cili emërohet ose caktohet për të shërbyer në një bord/komision profesional apo organ tjetër përkatës që kërkon ekspertizë profesionale dhe që përbën funksion shtesë, ka të drejtë në kompensim për ushtrimin e këtij funksioni, në pajtim me kriteret e përcaktuara me këtë Rregullore.

2. Kompensimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mbajnë zyrtari i Akademisë, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit.

Neni 5

Kriteret për përfitimin

1. Nëse zyrtari i Akademisë, kërkohet që të shërbejë në ndonjë grup, ekip punues, autoritet apo organe të ngjashme ky zyrtar i Akademisë nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim.

2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, shërbim konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të zyrtarit të Akademisë.

3 . Përfundimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme:

- 3.1. përfshirja në komision/bord përbën funksion shtesë për zyrtarin e Akademisë;
- 3.2. funksioni nuk bën pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari i Akademisë e ushtron;
- 3.3. përfshirja në Komision/bord kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari i Akademisë e posedon;
- 3.4. angazhimi në funksionin shtesë nuk përfshihet në detyrat dhe përgjegjësitë e zakonshme që burojnë nga pozita e zyrtarit në Akademi;
- 3.5. për funksionin shtesë ekziston vendim i organit kompetent për emërim apo themelimin e bordit apo komisionit;
- 3.6. ka ndikim të drejtpërdrejtë në realizimin e obligimeve ligjore dhe të objektivave strategjike të Akademisë ose të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Neni 6

Procedura për miratimin e kompensimit

1. Bordi/ Komisioni që emërohet ose themelohet në pajtim me përcaktimet e kësaj Rregulloreje, në vendimin për themelim duhet të përfshijë dispozitën për të drejtën e kompensimit të anëtarëve të tij.
2. Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni përcillet për realizim tek Divizioni për Buxhet dhe Financa i Akademisë.
3. Përgjashtimisht, për anëtarët e Këshillit Drejtues, nuk kërkohet plotësimi i kriterëve kumulative të përcaktuara për funksionet shtesë. Angazhimi i tyre si anëtarë i Këshillit Drejtues konsiderohet funksion shtesë jashtë detyrave të rregullta të punës, dhe ata kanë të drejtë të përfitojnë kompensimin për funksion shtesë sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, edhe pa specifikim të veçantë në aktin e emërimit të tyre.

Neni 7

Vlera e kompensimit

1. Kompensimi për funksion shtesë bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo ndonjë organi tjetër përkatës.
2. Kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër përkatës mbledhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje.
3. Kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër përkatës mbledhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje.

KAPITULLI III

Neni 8

Kategorizimi i sistemit SMAT

Për zbatimin e shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Sistemi Informativ për Menaxhimin e Aktiviteteve Trajnuese (SMAT) konsiderohet sistem shtetëror i informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike në fushën e drejtësisë.

Neni 9

Kriteret për kategorizimin e SMAT

1. Sistemi për Menaxhimin e Aktiviteteve Trajnuese (SMAT) konsiderohet sistem shtetëror i informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike në fushën e drejtësisë, për arsye se:

1.1 është sistem unik në nivel shtetëror që mbulon procesin e plotë të trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme për gjyqtarë, prokurorë dhe staf mbështetës të institucioneve të drejtësisë, duke ndikuar drejtpërdrejt në përgatitjen profesionale dhe cilësinë e sistemit të drejtësisë;

1.2. është sistem kompleks elektronik që përmban dhe menaxhon të dhëna të ndjeshme dhe personale, përfshirë pjesëmarrës, trajnues, kalendarë trajnimesh, testime, vlerësime dhe dokumente zyrtare, të cilat kanë ndikim në realizimin e detyrave ligjore të Akademisë së Drejtësisë, në përputhje me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Akademinë e Drejtësisë;

1.3. ndikon drejtpërdrejt në realizimin e obligimeve ligjore të Akademisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera shtetërore në fushën e drejtësisë, duke siguruar qasje të integruar në të dhëna, raportim të saktë dhe përmbushje të detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin përkatës;

1.4. kontribuon në realizimin e objektivave shtetërore dhe raportimeve ligjore të institucioneve të drejtësisë, përfshirë Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën e Kryeministrit dhe partnerët ndërkombëtarë, përmes raporteve zyrtare dhe statistikave të sakta;

1.5. ka funksione të avancuara të raportimit dhe analizimit të të dhënave, që mundësojnë transparencë, llogaridhënie dhe planifikim strategjik në fushën e trajnimeve gjyqësore dhe prokuroriale;

1.6. është i ndërveprueshëm me sistemet e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, duke siguruar sinkronizim dhe shkëmbim të sigurt të të dhënave;

1.7. përmban masa të veçanta të sigurisë teknike dhe kibernetike, në përputhje me standardet e Agjencisë për Shoqëri të Informacionit (ASHI), për të garantuar integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e të dhënave;

1.8. është pronë institucionale e Akademisë së Drejtësisë, e regjistruar zyrtarisht në Agjencinë për Shoqëri të Informacionit (ASHI);

1.9. ndikon në sigurimin e shërbimeve esenciale për sistemin e drejtësisë, duke përforcuar zhvillimin profesional të bartësve të funksioneve gjyqësore, prokuroriale dhe zbatimin efektiv të politikave shtetërore në fushën e sundimit të ligjit.

Neni 10 **Pozitat si ekspert**

1. Pozitat kyçe që janë përgjegjëse për dizajnimin, menaxhimin, koordinimin, zhvillimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e SMAT-it në Akademi, dhe kategorizimi i tyre sipas klasave të përcaktuara në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, janë si vijon:

1.1 Udhëheqës i Divizionit për TI - Ekspert 5, Klasa: B3, Koeficienti: 13

1.2 Zyrtar i Lartë i TI-së për Sisteme - Ekspert 7, Klasa: B7, Koeficienti: 10

Neni 11 **Planifikimi buxhetor**

Akademia e Drejtësisë, për secilin vit buxhetor, obligohet të përfshijë në planifikimin buxhetor mjetet për kompensime, për funksione shtesë dhe për pozitat e ekspertëve, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 12 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.


Fejzullah Rexhepi
Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë